



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 12 korrik 2010
Ref. Nr.: RK 35/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 44/09

Parashtruesi i kërkesës

Metush Haziri

kundër

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, A. Nr. 2705/2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Njëzëri miraton **Vendimin** në vijim mbi papranueshmërinë e rastit.

HYRJE

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i Kërkesës është z. Metush Haziri, nga Ferizaj

Vendimi i sfiduar

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, A. Nr. 2705/2007, datës 10 mars 2008.

Çështja e lëndës

3. Me 28 shtator 2009 z. Metush Haziri, nga Ferizaj, ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, e cila është regjistruar me Nr. KI 44/09. Parashtruesi i kërkesës kundërshton ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. Nr. 2705/2007, për të drejtën në pension.

Baza ligjore

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Ligji), si dhe neni 55 i Rregullores së Punës së të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm Rregullorja).

Përmbledhje e procedurës para Gjykatës

5. Kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 28 shtator 2009. Kryetari i Gjykatës emëroi Iliriana Islamin si gjyqtare raportuese dhe caktoi kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtari Altay Suroy, kryesues, Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj. Më 16 qershor 2010, Gjykata shqyrtoi pranueshmërinë e kërkesës së parashtruesit.

Faktet

6. Parashtruesi i kërkesës ka sqaruar në kërkesën e tij se ka punuar në organet shtetërore nga data 15 mars 1973 deri me 30 qershor 1989. Në pajtim me Nenin 39 të Ligji mbi të Drejtat Themelore mbi Sigurimin Pensional e Invalidor, BVI-Sigurimit Pensional Invalidor, Njësia Organizative Ferizaj, ka nxjerr Aktvendimin NR-V-3468/7006799138, të datës 10 korrik 1992, me të cilin parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta në pension të vjetërsisë prej datës 1 korrik 1989.
7. Me 6 dhjetor 1989, Komisioni për Çështje Administrative dhe të Kuadrove të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës, në bazë të Nenit 124 të Ligjit për Punë të Brendshme, sipas së cilit "Personave të autorizuar zyrtar çdo dymbëdhjetë muaj të kaluara efektivisht në këto detyra u llogariten si gjashtëmbëdhjetë muaj stazhi (përvojë) të sigurimit", ka nxjerr Aktvendim me të cilin Refuzohet kërkesa e parashtruesit për prapësim (kthim) në vendin e punës.
8. Pas Vitit 1999 dhe themelimit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse,, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, vazhdimin e të drejtës në pension në pajtim me Vendimin NR. 3468/7006799138, të datës 10 korrik 1992.
9. Me 22 tetor 2007, Sektori për Ankesa i Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjigjur në parashtruesin e parashtruesit, ku thekson se sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/10 Departamenti Administrativ i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk është trashëgimtar – suksesor i BVI-Sigurimit Pensional e Invalidor të Kosovës. Ndërsa theksohet se me Udhëzim të veçantë Nr. 3/2001 është formuar Fondi për Sigurime Shoqërore të Kosovës dhe se nga data 1 korrik 2002 pensionet bazë sigurohen nga Departamenti Kalimtar dhe i Mirëqenies Sociale vetëm për personat me moshë mbi 65 vjeçare, në lartësi prej 40 euro.

10. Gjithashtu, me të njëjtën përgjigje është refuzuar kërkesa e parashtruesit për pension me aftësi të kufizuar për faktin se pas ekzaminimeve mjekësore profesionale është konstatuar se tek parashtruesi i kërkesës nuk ekziston aftësia e kufizuar dhe e plotë e përhershme.
11. Me 29 korrik 2008, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjigjur në Ankesën e Parashtruesit për pension të vjetërsisë (pension i fituar në bazë të kontributeve), ku theksohet se kërkesa e parashtruesit nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së infrastrukturës ligjore dhe mungesës së mjeteve buxhetore;
12. Me 10 mars 2008, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr Aktgjykim me numër të referencës: A. nr. 2705/2007, me të cilin vërteton se organet administrative kanë zbatuar drejtë ligjin e aplikueshëm në Kosovë dhe se Paditësi nuk plotëson kushtet ligjore për njohjen e së drejtës së kërkuar, ku si rezultat Refuzohet Padia si e pa bazuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

13. Me qëllim të vendosjes mbi kërkesën e parashtruesit, fillimisht Gjykata ekzaminoi dokumentacion në dispozicion dhe analizoi nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kriteret e lejueshmërisë, siç parashihet në Kushtetutë. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh si në vijim:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se parashtruesi i kërkesës i ka shtjerr të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

14. Neni 48 i Ligjit përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

Parashtruesi nuk ka cekur apo përkufizuar në mënyrë të qartë se cilat të drejta dhe liri ai pretendon se i janë shkelur sipas Kushtetutës dhe nuk ka mbështetur me asnjë fakt shkeljen konkrete të ndonjë të drejtë Kushtetuese që eventualisht i është cenuar. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë-fakt relevant për të treguar se organet administrative apo gjyqësore kanë bërë ndonjë shkelje të të drejtave të tij, të garantuara me Kushtetutë (shih Vanek v. Republika Sllovaqe, GJEDNJ Vendimi mbi Pranueshmërinë e rastit Nr. 53363/99 të datës 31 maj 2005). Rrjedhimisht, Gjykata **nuk mund të** konsideron se parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriterin e përcaktuar në Nenin 48 të Ligjit.

15. Neni 56 i Ligjit përcakton:

“Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Neni 56 i Ligjit ndërlidhet me Nenin 49 të Ligjit, si më poshtë, i cili përcakton afatet kohore për parashtrimin e kërkesave individuale sipas Nenit 113 (7) të Kushtetutës dhe Nenit 47 të Ligjit:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht”.

Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese me datën 28 shtator 2009, ndërsa Vendimi i fundit në lidhje me këtë rast është ai i Gjykatës Supreme të Kosovës, datë 10 mars 2008, dhe çështja ka të bëjë me një periudhë që daton para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih Blečić v. Kroaci, kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, 29 korrik 2004), prandaj, përfundon se kërkesa është e parashkruar.

Por edhe sikur të kjo kërkesë të parashtrohej në pajtim me afat kohor, Gjykata nuk ka gjetur se në këtë rast është shkelur ndonjë e drejtë Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Pasi që Gjykata analizoi të gjitha faktet dhe dëshmitë e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, dhe pas shqyrtimit të çështjes, në pajtim me Nenin 113 (7) të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit dhe Nenin 55 të Rregullores, në seancën e datës 12 korrik 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. **PËR TË REFUZUAR** kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky Vendim do t'i dërgohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Dr. Iliriana Islami, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.